

VENDIM
Nr. 669, datë 10.11.2021

**PËR KRITERET E EMËRIMIT, SHKAQET E LIRIMIT APO TË SHKARKIMIT,
SI DHE SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMBËTAR PËR
AZILIN E REFUGJATËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryetari i Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese (anëtar i TND-së) dhe propozohet nga ministri përgjegjës për çështjet e azilit.

2. Katër anëtarët e tjerë të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët (në vijim, Komisioni) propozohen nga secili prej institucioneve: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe Shërbimi Informativ i Shtetit e duhet të plotësojnë këto kritere:

a) të jenë diplomuar në shkenca shoqërore;
b) të jenë nëpunës civilë ose në pozicione ekuivalente jashtë shërbimit civil, të paktën, të nivelit të mesëm drejtues;

c) të kenë eksperiencë profesionale jo më pak se 5 (pesë) vjet në administratën publike;

ç) të pajisen me certifikatë sigurie, niveli “sekret”.

3. Anëtari i Komisionit lirohet nga detyra në rastet kur:

a) mbaron mandati;

b) jep dorëheqjen;

c) përfundon marrëdhënia e punës me institucionin që ai përfaqëson.

4. Anëtari i Komisionit shkarkohet nga detyra në rastet kur:

a) nuk merr pjesë pa arsye në mbledhjet e Komisionit për më shumë se 2 (dy) herë radhazi;

b) veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë e Komisionit;

c) nuk ruan konfidencialitetin e informacioneve ose i përdor ato për interesa personale;

ç) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) ushtron veprimtarinë në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Anëtarët e Komisionit të shpërblehen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose të komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore.

6. Vendimi nr. 206, datë 16.3.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama